



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 162/ 13 prot.

Datë 04/03/2026

V E N D I M
Nr. 348/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04/03/2026, mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt:

Kërkesë për rishikim vendimi Nr. 301/2026, datë 24.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor” me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote, si më poshtë”, me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: “Blerje kite”, Për ISUV”, me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Drejtuar:

Komisionit të Prokurimit Publik
Adresa: Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë

Kërkuesi:

Operatori ekonomik "GAMMA" SHPK
Adresa: Rruga "Dervish Hekali", Nr. 8, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik". Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19".

Komisioni i Prokurimit Publik, dëgjoi relatorin e çështjes, e pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I****Rrethanat e çështjes**

I.1. Në datën 01.10.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor" me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: "Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike" e ndarë në 9 lote, si më poshtë", me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: "Blerje kite", Për ISUV", me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

I.2. Në datë 22.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

I.3. Në datë 30.12.2025, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve (SPE) me klasifikimin përfundimtar të ofertave, si më poshtë vijon:

1	<i>"GAMMA" SHPK</i>	13.497.000	leke	kualifikuar
2	<i>"KRIJON" SHPK</i>	15.551.000	leke	kualifikuar
3	<i>"ISOMETRIC" SHPK</i>	19.913.840	leke	kualifikuar

I.4. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE) konstatohet, se në datën 08.01.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë *"GAMMA" SHPK*

I.5. Në datën 19.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6258, datë 19.01.2026 dhe numër protokoli nr. 162/2026, datë 20.01.2026 e operatorit ekonomik *"KRIJON" SHPK*, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *"GAMMA" SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.6. Në përputhje me nenin 112 *"Veprimet paraprake"* të Ligjit nr.162/2020 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 162/1 prot, datë 20.01.2026, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *"KRIJON" SHPK*, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik *"GAMMA" SHPK*, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura ne fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik *"GAMMA" ShPK*, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *"KRIJON" ShPK* përse i përket skualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, me numër argumenti elektronik C/2026/822, datë 23.01.2026 të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 162/2 prot, datë 23.01.2026.

I.8. Nga shqyrtimi i akteve te ndodhura ne fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik *"GAMMA" ShPK*, nëpërmjet rrugës postare ka paraqitur argumenta lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *"KRIJON" ShPK* përse i përket skualifikimit të ofertës së tij sipas parashikimeve të nenit 113 të Ligjit nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 162/3 prot, datë 26.01.2026.

I.9. Në datë 30.01.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 4251/27 prot, datë 29.01.2026, *"VENDIM K.SH.A 13/2026"* protokolluar me tonën me nr. 162/4 prot, datë 30.01.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimmarrja e

Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "KRIJON" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.10. Me shkresën nr. 4251/28 prot, datë 29.01.2026, *“Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KRIJON” shpk lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-63114-09-30-2025, me object: Loti 8 ‘Blerje kite’.*”, protokolluar me tonën me numër 162/5 prot, datë 02.02.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe shkresa e autoritetit kontraktor nr. 4251/27 prot, datë 29.01.2026, *“VENDIM K.SH.A 13/2026”* protokolluar me tonën me nr. 162/4 prot, datë 30.01.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimmarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "KRIJON" SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura ne fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik "KRIJON" ShPK, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka paraqitur argumenta lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "KRIJON" SHPK, me numër argumenti elektronik C/2026/837, datë 05.02.2026 të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 162/6 prot, datë 05.02.2026.

I.12. Komisioni i Prokurimit Publik, me Vendimin nr. 301/2026, datë 24.02.2026, ka vendosur:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KRIJON” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor” me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote, si më poshtë”, me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: “Blerje kite”, Për ISUV”, me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.11. Me shkresën nr. 80029 prot, datw 02.03.2026 me objekt “Kërkesë për korrigjim vendimi” protokolluar me tonën me nr. 162/11 prot, datë 03.03.2026, operatori ekonomik “GAMMA” SHPK kërkon si më poshtë vijon:

[...] Po ju paraqesim sqarime dhe dokumentacion konfidencial lidhur me marrëdhënien kontraktuale me “XXX” S.p.a. në kuadër të Vendimit Nr. 301/2026

Në vijim të Vendimit Nr. 301/2026, lidhur me procedurën e prokurimit “Loti 8 - Blerje kite” dhe me numër reference REF-63114-09-30-2025, paraqesim këtë shkresë me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave faktike dhe juridike lidhur me marrëdhënien tonë me shoqërinë italiane “XXX” S.p.a., e cila është konsideruar element problematik në arsyetimin e vendimit.

Në procedurën objekt shqyrtimi, kërkesa për autorizim prodhuesi është hequr me Vendimin Nr. 1690/2025, datë 17.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, vendim i dhënë posaçërisht për këtë procedurë prokurimi, pas ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “KRIJON” sh.p.k.

Në atë vendim, KPP ka vlerësuar se kërkesa për autorizim prodhuesi përbën dokument të tepërt dhe potencialisht kufizues të konkurrencës, duke orientuar heqjen e saj nga dokumentet e tenderit.

Në këto kushte, vlerësojmë se kërkimi në mënyrë të tërthortë i provës së marrëdhënies së distributorit me prodhuesin, në fazën e justifikimit të ofertës anomalisht të ulët, përbën rikthim material të një kriteri që është hequr me vendim të formës së prerë të vetë KPP-së për këtë procedurë.

Një qasje e tillë cënon parimin e sigurisë juridike dhe të parashikueshmërisë së vendimmarrjes administative, pasi operatorët ekonomikë duhet të kenë qartësi mbi kriteret dhe standardet e kërkuara në procedurë, pa iu nënshtruar standardeve të reja apo të zgjeruara pas hapjes së ofertave.

Neni 93 i Ligjit "Pëi Prokurimin Publik" kërkon që operatori ekonomik të justifikojë ekonomisht ofertën anomalisht të ulët përmes metodës së përzgjedhur, kushteve favorizuese, zgjidhjeve teknike apo avantazheve specifike ekonomike.

Ky nen nuk parashikon detyrimin për të provuar zinxhirin tregtar ndërmjet furnizuesit dhe prodhuesit, sidomos kur një kërkesë e tillë nuk ka qenë kriter kualifikues në procedurë.

Në rastin konkret, avantazhi ekonomik buron nga marrëdhënia jonë e konsoliduar kontraktuale me furnizuesin, e cila garanton stabilitet çmimi dhe furnizim të qëndrueshëm, çka përbën bazë reale dhe të verifikueshme ekonomike për ofertën tonë.

Marrëdhëniet tregtare ndërmjet "XXX" S.p.a. dhe prodhuesve përbëjnë informacion konfidencial dhe sekret tregtar të kësaj shoqërie, i mbrojtur nga legjislacioni përkatës dhe nga praktikat ndërkombëtare të tregtisë.

Shoqëria jonë nuk ka kompetencë ligjore dhe as të drejtë kontraktuale për të detyruar furnizuesin të zbulojë marrëdhëniet e tij me prodhuesit, pasi kjo do të cënonte drejtpërdrejt interesat e tij tregtare dhe konkurruese.

Vendosja e një standardi të tillë verifikimi, përtej dokumenteve të kërkuara në procedurë, cënon parimin e proporcionalitetit, sigurisë juridike dhe parimin e mosvendosjes së kriterëve të reja pas hapjes së ofertave.

Shoqëria jonë ka në fuqi një kontratë disa-vjeçare me "XXX" S.p.a., e cila parashikon furnizim të produkteve përkatëse me çmime të qëndrueshme dhe të garantuara. Kjo kontratë përbën bazën reale ekonomike mbi të cilën është ndërtuar oferta jonë dhe garanton realizimin e plotë të kontratës publike.

Në funksion të transparencës dhe qartësisë të plotë të situatës, bashkëngjitur kësaj shkrese po ju paraqesim kontratën në fjalë me trajtim konfidencial, duke kërkuar që ajo të administrohet dhe trajtohet si dokument me përmbajtje të ndjeshme tregtare.

Shoqëria jonë, gjatë gjithë historikut të veprimtarisë së saj në prokurimet publike, ka paraqitur vazhdimisht oferta konkurruese në treg, duke kontribuar në uljen e kostove për fondet publike. Megjithatë, faktet objektive tregojnë se çmimet konkurruese të paraqitura nga ne nuk kanë qenë asnjëherë të shoqëruara me ulje të cilësisë apo me mosrealizim të kontratave. Nuk ekziston asnjë masë administrative, penalitet kontraktual apo ankesë e autoriteteve kontraktore për mosrealizim, vonesa të pajustificuara apo cenim të standardeve të cilësisë nga ana jonë.

Ky historik përbën provë konkrete të qëndrueshmërisë sonë financiare, seriozitetit profesional dhe aftësisë për të realizuar kontrata publike me çmime konkurruese, pa krijuar asnjë rrezik për interesin publik.

Diferenca ndërmjet ofertës sonë dhe ofertës së operatorit tjetër është e konsiderueshme dhe përfaqëson një kursim të ndjeshëm për fondet publike, pra për taksapaguesit shqiptarë.

Oferta jonë është ndërtuar mbi analiza reale kostoje dhe mbi marrëdhënie kontraktuale të qëndrueshme, me marzh fitimi të arsyeshëm, duke garantuar njëkohësisht realizimin korrekt të kontratës dhe optimizimin e shpenzimit publik.

Në këto kushte, një kërkesë për sqarim shitesë do të kishte qenë mjeti proporcional për të qartësuar çdo paqartësi përpara arritjes në përfundimin e skualifikimit.

Shoqëria jonë mbetet e angazhuar për respektimin rigoroz të kuadrit ligjor, për garantimin e konkurrencës së ndershme dhe për mbrojtjen e interesit publik në çdo procedurë prokurimi. [...]”.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Në kuptim e zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. (neni 24 i LPP).

II.2. Në datën 24.02.2026 Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr. 301/2026, ka vendosur:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “KRIJON” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor” me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote, si më poshtë”, me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: “Blerje kite”, Për ISUV”, me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.*

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KRIJON” SHPK
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.3. KPP në lidhje me vendimarrjen gjykon se ligjvënësi ka parashikuar rregulla strikte mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 24/3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se: “3. Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime për ankesat e paraqitura para tij dhe nxjerr interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, të cilat zbatohen për sa janë të vlefshme në vendimarrjet e ardhshme. Në marrjen e vendimeve mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.”.

Lidhur me argumentat e paraqitura në kërkesën tuaj ju sjellim në vëmendje se KPP, nuk mund të komentojë apo shpjegojë vendimet e tij përtej shpjegimeve të bazuara në ligj e argumenteve faktike të cilat i ka paraqitur në pjesën “arsyetoi” të vendimit.

Gjithashtu KPP, sjell në vëmendje të ankimuesit se neni 30 pika 2 i Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar thekson se: “2. Vendimet e marra nga Komisioni janë administrativisht përfundimtare. Këto vendime mund të ankimohen në Gjykatën Administrative të Apelit, në përputhje me nenin 121 të këtij ligji. ”.

Për më tepër KPP, sjell në vëmendje të kërkuarit se në pikën 3 dhe pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.4.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik” përcaktohet se:

“3. Parapagimi i tarifës nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar është kusht i domosdoshëm për pranimin dhe shqyrtimin e ankesës. Në rastet e moskryerjes së pagesës, autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik i lind e drejta e mospranimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues ose operatori ekonomik i interesuar. Në çdo rast, pagesa e tarifës i kthehet operatorit ekonomik ankimues ose operatorit ekonomik të interesuar, i cili ka kundërshtuar vendimin e autoritetit

ose entit kontraktor, nëse ankesa e tyre është pranuar plotësisht ose pjesërisht nga Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e vendimit nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

4. Në rastin kur ankesa nuk pranohet, të ardhurat e arkëtuara nga tarifa e ankimit derdhen 100% në buxhetin e shtetit.”.

II.4. Instituti i rishikimit nga ana e një organi administrativ të një vendimi të nxjerrë nga vetë organi në fjalë, nuk gjen mbështetje ligjore në parashikimet e nenit 144, të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” në fuqi, pasi nuk jemi në rastin e parashikuar në këtë dispozitë ligjore, ndaj KPP vlerëson se duhet ti drejtohet me analogji Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se: “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:

a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

e) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

ë) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga RSH.”.

II.5. Në kërkesën e operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor” me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote, si më poshtë”, me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: “Blerje kite”, Për ISUV”, me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se argumentet e shoqërisë “GAMMA” SHPK kanë të bëjnë me rishikimin e pikës 1 të dispozitivit të vendimi Nr. 301/2026, datë 24.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me mospranimin e pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “KRIJON” SHPK, përse i përket pretendimit të tij se operatori ekonomik “GAMMA” SHPK

nuk ka arritur që të argumentojë ofertën e tij ekonomike e cila ka rezultuar anomalisht e ulët, pretendim i parashtruar nga ankimuesi në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6258, datë 19.01.2026 dhe numër protokolli nr. 162/2026 prot, datë 20.01.2026, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e mësipërm të parashtruar nga operatori ekonomik ankimues “KRIJON” SHPK në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6258, datë 19.01.2026 dhe numër protokolli nr. 162/2026 prot, datë 20.01.2026, Komisioni i Prokurimit Publik referuar dokumentit të emërtuar “Oferta_teknike_kitet” të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës së operatorit ekonomik ofertues “GAMMA” SHPK dhe shkresës “Argumentim oferte” të datës 23.12.2025, të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “GAMMA” SHPK, sipas interpretimeve në pikën III.1.11., të vendimi Nr. 301/2026, datë 24.02.2026, Komisioni ka pranuar këtë pretendim të ankimuesit, pasi nga ana e operatorit ekonomik ankimues “GAMMA” SHPK, nuk është paraqitur argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje me nenin 93 pika 2 të LPP-së, ndaj oferta e këtij operatori duhet të skualifikohet nga ana e autoritetit kontraktor.

KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Akoma më tej, duke qenë se KPP është organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse.

Si përfundim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e paraqitur nga operatori ekonomik “GAMMA” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.4.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Mospranimin e kërkesës së operatorit ekonomik “GAMMA” SHPK, për rishikimin e Nr. 301/2026, datë 24.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit *E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, marreveshje kuader me disa operatore ekonomike ku te gjitha kushtet jane te percaktuara, me afat 12 mujor*” me numër reference Nr. REF-63093-09-30-2025, me objekt: “Blerje pajisje laborator, enë, reagent, gaze, terrene, kite, standarte dhe kolona kromatografike” e ndarë në 9 lote, si më poshtë”, me fond limit të përgjithshëm 103,383,084 (njëqind e tre milion e treqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 1,067,456 (një

milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) Euro pa TVSH, Loti 8 me numër reference të lotit Nr. REF-63114-09-30-2025, me objekt: “Blerje kite”, Për ISUV”, me fond limit të lotit 21,205,399 (njëzet e një milion e dyqind e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 218 951 (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) Euro pa TVSH, zhvilluar në datën 22.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini
Nënkryetar		
Fiorent Zguro		

